

KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.2367/3, datë 22.12.2011

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë (loti 7 rrugët dytësore, tokat).

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Në proces regjistrimi nga ZRPP” do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë DPRR-së.

Për pasuritë për të cilat nuk ka konfirmim nga ana e ZVRPP-së sqarojmë se personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 130 900 655 (njëqind e tridhjetë milionë e nëntëqind mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi